Komentari parashikon se, për qëllime të përcaktimit nëse një Njësi ose Njësi Investimi e përshkruar në Seksionin VIII, paragrafi A(6)(b), menaxhohet nga një Njësi tjetër nëse Njësia Menaxhuese kryen në mënyrë direkte ose nëpërmjet një ofruesi shërbimesh, ndonjë nga aktivitetet ose operacionet e parashikuara në paragrafin (A)(6)(a), për llogari të Njesisë menaxhuese. Këto aktivitete dhe operacione përfshijnë: tregti në instrumentet e tregut të parasë; këmbim valutor; këmbim, normë interesi dhe instrumente indeksi; letra me vlerë të transferueshme; ose transaksione me kontratat e së ardhmes (future) për mallrat; menaxhim të portofoleve individuale dhe kolektive; ose gjithashtu investimin, administrimin ose menaxhimin e aktiveve financiare ose parave për llogari të personave të tjerë. Më tej, Njësia menaxhuese duhet të ketë autoritet diskrecionar për menaxhimin e asetëve të Njesisë (në tërësi ose pjesërisht). Shih Komentin mbi Seksionin VIII, prgr. 17.

Për shembull, një kompani private kapitali që vepron si zyrë e regjistruar ose si agjent i një trusti, ose që kryen shërbime administrative që nuk lidhen me asetet financiare në para të trustit, nuk kryen aktivitetet dhe operacionet e parashikuara në Seksionin VIII, nënparagrafi (A)(6)(a) për llogari të trustit, e për rrjedhojë trusti nuk “menaxhohet” nga kompania private e trustit, sipas kuptimit që jepet në Seksionin VIII, paragrafi (a)(b)(6).

4. Mbështetja në përkufizimin e “Entitetit të Investimit” sipas Modelit 1 të Marrëveshjes Ndërqeveritare FATCA (IGA) për qëllime të CRS

A munden juridiksionet të mbështeten në përkufizimin e Njesisë së Investimit të përdorur në Modelin 1 FATCA IGA, për qëllime të zbatimit të CRS?

Jo, përkufizimi i Njesisë së Investimit në Nenin 1(1)(j) të Modelit 1 FATCA IGA, nuk mund të përdoret për qëllime të CRS si i vetë, pasi është më pak normativ se përkufizimi i Njesisë së Investimit I dhënë në Seksionin VIII(A)(6). Megjithatë, përkufizimet e Modelit 1 FATCA IGA dhe CRS, mund të lexohen vazhdimisht. Për shembull, përkufizimi i CRS përfshin një test të të ardhurave bruto, për përcaktimin nëse Njësia trajtohet se kryen fillimisht si biznes, një osë më shumë nga aktivitetet e parashikuara në nënparagrafin A(6)(A), ose të ardhurat bruto të Njesisë I atribuohen fillimisht investimit, riinvestimit, ose tregtisë së Aseteve Financiare, për qëllime të nënparagrafin A(6)(b) dhe mund të përdoret për interpretimin e aspekteve më pak urdhëruese të përkufizimit të Modelit 1 FATCA IGA. Përkufizimi i CRS në fakt bazohet në përkufizimin e Njesisë së Investimit në rregulloret US FATCA, që mund të përdoret për të interpretuar përkufizimin e Modelit 1 FATCA IGA.

5. Investimi indirekt në pasuri të paluajtshme

Nëse të ardhurat bruto të Njesisë i atribuohen fillimisht investimit indirekt në pasuri të paluajtshme, a do të ketë kjo Njësi statusin e një njësië të Investimit?

Njësia, të ardhurat bruto të së cilës i atribuohen fillimisht investimit, riinvestimit apo tregtisë së pasurisë së paluajtshme, nuk është një Njësi Investimesh (pavarësisht nëse menaxhohet hnë mënyrë profesionale), pasi pasuria e paluajtshme nuk përbën një Aset Financiar (shih komentin mbi seksionin VIII, prgr. 17). Nëse përkundrazi, Njësia që mban një interes tek një njësi tjetër, që mban në mënyrë direkte pasuri të paluajtshme, interesi I mbajtur nga Njësia e parë e përmendur është një Aset Financiar dhe të ardhurat bruto të marra nga ky interes do të merren në konsideratë në përcaktimin nëse Njësia përputhet me përkufizimin e Njesisë së Investimeve sipas Seksionit VIII, nënparagrafi (A)(6)(a)(iii) ose paragrafi (A)(6)(b). Shih seksionin VIII, nënparagrafi (A)(7) për përkufizimin Asetit Financiar.

6. Përkufizimi i Njesisë Investuese – “menaxhuar nga”

Sipas Seksionit VIII (A)(6)(b), a përfshin nocioni “menaxhuar nga” rastet kur një Njësi ka autoritet diskrecionar për menaxhimin e aseteve (në tërësi ose pjesërisht) të një Njesisë tjetër, por nuk menaxhon vetë Njësinë sekondare?

Po, koncepti “menaxhuar nga” sipas Seksionit VIII (A)(6)(b), përfshin gjithashtu edhe rastet kur një Njësi ka autoritet diskrecionar për menaxhimin e aseteve (në tërësi ose pjesërisht) të një Njesisë tjetër, por që nuk menaxhon vetë Njësinë sekondare.

7. Përkufizimi i Njësisë së Investimeve – testi i aktivitetit substantial

Në përcaktimin nëse një Njësi përmbush testin e “të ardhurave bruto 50%”, sipas përkufizimit të Njësisë së Investimeve, a lejohet të zbatohet testi tre vjeçar në ditën e fundit të periudhës kontabël të vitit jokalendarik, sic parashikohet për “testin 20% të të ardhurave bruto” për Institucionet e Kujdestarise?

Po. Në përputhje me qasjen e zgjedhur për Institucionet e Kujdestarisë, testi tre vjeçar për përcaktimin nëse një njësi ekonomike përmbush "testin e të ardhurave bruto 50%" nën përkufizimin e Entit për Investime mund të aplikohet në ditën e fundit të një periudhe kontabël jokalendarike të vitit paraprak të vitit në të cilin bëhet përcaktimi.

8. Ofruesit e e-parasë – kualifikimi si Institucion Depozite

Cili është statusi i ofruesve të parasë elektronike për qëllime të CRS?

Nuk ka rregulla të vecanta për t’u zbatuar ngaj ofruesve të parasë elektronike. Ashtu si pjesëmarrësit e tjerë të industrisë financiare, ata duhet të përcaktojnë nëse përbëjnë një Institucion Financiar, sipas përkufizimit që jep CRS. Ky përcaktim do të varet nga faktet dhe rrethanat. Për shembull, për të përcaktuar nëse një ofruer i parasë elektronike është një Institucion Depozitues, analiza duhet të kryhet duke u referuar tek Seksioni VIII (A)(5) dhe komentit përkatës, në vecanti paragrafi 13.

9. Trajtimi i të besuarve (*trustees*) të korporatave dhe kujdestarët SPV

Në rrethana të caktuara, një firmë profesionale kontabiliteti ose një firmë ligjore, krijon një trust për një klient dhe si pjesë e këtij procesi, cakton një të besuar të korporatës. Më pas, klienti paguan firmën e kontabilitetit ose firmën ligjore për të gjitha shërbimet e ofruara në lidhje me krijimin e trustit, përfshirë edhe caktimin e të besuarit të korporatës dhe të shërbimeve të tjera të të besuarit. Si i tillë, vetë i besuari i korporatës nuk përfiton një shpërblim direkt për shërbimet e kryera prej tij, pasi shpërblimi i paguhet firmës së kontabilitetit ose firmës ligjore, si pjesë e paketës fillestare.

Në këtë këndvështrim, për qëllime të testeve të të ardhurave bruto që do të aplikohen në kontekstin e përkufizimeve të Njësisë së Investimit dhe Institucionit të Kujdestarise, a kërkohet që shpërblimi për aktivitetet e kryera t’i paguhet Njësisë, ndaj së cilës kryhet testi?

Jo. Për qëllime të testit të të ardhurave bruto që do të kryhet në kontekstin e përkufizimeve të Njësisë së Investimit dhe Institucionit të Kujdestarisë, të gjitha shpërblimet për

veprimtaritë përkatëse të një Njësie duhet të merren parasysh, pavarësisht nëse shpërblimi i është paguar direkt Njësisë ndaj të cilës është kryer testi, apo një Njësie tjetër. Ky problem mund të ngrihet edhe në kontekst të Njësive që ofrojnë shërbime kujdestarie, nëse tarifat për shërbime të tilla i paguhen një Njësie tjetër.

10. Fusha e interesit në një Kripto-Aset Përkatës sipas përkufizimit të Aktivës Financiare (CRS i ndryshuar)

Sipas Seksionit VIII(A)(7) të CRS mbi Termat e Përkufizuar, çdo interes në një Kripto-Aset Përkatës përfshihet në përkufizimin e Aktivës Financiare dhe për rrjedhojë i nënshtrohet raportimit sipas CRS. Çfarë lloj interesash në një Kripto-Aset Përkatës përfshihen në këtë përkufizim?

Llojet e interesave që përfshihen në përkufizimin e Aktivës Financiare janë interesat derivativë që referojnë një Kripto-Aset Përkatës, si kontratat futures, kontratat forward dhe optionet. Në kontekstin e Kripto-Aseteve Përkatëse, kjo nuk përfshin interesat në asete që lindin nga marrëveshje të zakonshme kujdestarie (custody).

11. Aktiva Financiare të emetuara ose të tokenizuara në mënyrë digjitale (CRS i ndryshuar)

A kualifikohet një Aktiv Financiar i emetuar ose i tokenizuar në mënyrë digjitale si “Kripto-Aset” sipas Seksionit IV(A)(1) të CARF dhe Seksionit VIII(A)(12) të CRS të ndryshuar, kur për arsye rregullatore ose të tjera ligjore, ai mund të mbahet dhe transferohet vetëm përmes Llogarive të Kujdestarisë të administruara nga një ose më shumë Institucione Depozituese ose Kujdestare, ose kur ai përfaqëson një Interes Kapitali në një Entitet Investimi të rregulluar që mund të regjistrohet dhe transferohet vetëm përmes vetë Entitetit të Investimit me mjete tradicionale ose përmes një regjistri të shpërndarë të kontrolluar nga Entiteti emetues ose agjenti i tij?

Përkufizimi i Kripto-Aseteve synon asetet që mund të mbahen dhe transferohen në mënyrë të decentralizuar, pa ndërhyrjen e ndërmjetësve tradicionalë financiarë. Gjithashtu, përkufizimi mbulon asetet që mbështeten në teknologji që lejon validimin dhe sigurimin e transaksioneve dixhitale në mënyrë të decentralizuar ose të çndërmjetësuar.

Prandaj, një Aktiv Financiar i emetuar ose tokenizuar në mënyrë digjitale nuk përfshihet në përkufizimin e Kripto-Asetit kur çndërmjetësimi nuk është i mundur, sepse asetit mund të mbahet dhe transferohet vetëm përmes Llogarive të Kujdestarisë ose sepse përfaqëson një Interes Kapitali në një Entitet Investimi të rregulluar që regjistrohet dhe transferohet vetëm përmes kanaleve tradicionale ose një regjistri të kontrolluar nga vetë entiteti

emetues. Në këto raste, dispozita opsionale e Seksionit I(G) të CRS të ndryshuar nuk zbatohet.

Në të kundërt, kur këto kushte nuk plotësohen, një Aktiv Financiar i emetuar ose tokenizuar në mënyrë dixhitale kualifikohet si Kripto-Aset dhe dispozita opsionale e Seksionit I(G) mund të zbatohet.

12. Produkte të Përcaktuara të Parave Elektronike – kërkesat për shlyerje (CRS i ndryshuar)

Termi “Produkt i Përcaktuar i Parave Elektronike” nënkupton një produkt që, ndër të tjera, është i shlyeshëm në çdo kohë dhe me vlerë nominale të plotë në të njëjtën monedhë Fiat, sipas kërkesave rregullatore që i aplikohen emetuesit.

Kërkesa duhet të plotësohet për të gjithë emetimin, në mënyrë që të gjitha njësitë ose tokenët e atij emetimi të jenë realisht subjekt i kësaj kërkesë.

Kufizimet thelbësore që në praktikë kufizojnë të drejtën e mbajtësit për të kërkuar shlyerje në çdo kohë dhe me vlerë nominale të plotë nuk janë në përputhje me kërkesat e CRS të ndryshuar.

Kufizimet procedurale ose prudenciale që zbatohen sipas ligjit (p.sh. tarifa të arsyeshme shlyerjeje, kontrole AML/CFT, kufizime në oraret e punës) janë të pranueshme, për sa kohë nuk cenojnë shlyerjen me vlerë nominale.

Për të përcaktuar nëse një produkt kualifikohet si Produkt i Përcaktuar i Parave Elektronike, një Ofrues Shërbimi i Kripto-Aseteve Raportues mund të mbështetet në autorizimet ose miratimet rregullatore përkatëse.

13. Produkte të Përcaktuara të Parave Elektronike – ndryshimi i statusit (CRS i ndryshuar)

Nëse një Kripto-Aset Përkatës bëhet Produkt i Përcaktuar i Parave Elektronike gjatë një periudhe raportimi, deri në datën kur plotësohen kriteret për këtë status, ai mbetet Kripto-Aset Përkatës dhe vazhdon të raportohet sipas CARF. Nuk duhet të bëhet riklasifikim retroaktiv për transaksionet e kryera më parë.

Nga data kur plotësohen kriteret, produkti përjashtohet nga CARF. Transaksionet e këmbimit trajtohen si këmbime me monedhë Fiat. Entitetet që e mbajnë produktin për klientët konsiderohen Institucione Depozituese për qëllime të CRS dhe duhet të raportojnë gjendjen e llogarisë në fund të vitit dhe interesin bruto, nëse ka.

Jurisdiksionet mund të lejojnë, për thjeshtësi, që produkti të trajtohet si Kripto-Aset Përkatës ose si Produkt i Përcaktuar i Parave Elektronike për të gjithë ose një pjesë të vitit kalendarik përkatës.

14. Produkte të Përcaktuara të Parave Elektronike – produkte me shumë monedha (CRS i ndryshuar)

A përmbushin kërkesën përfaqësimet digjitale të një monedhe të vetme Fiat në kuadër të portofolave elektronikë me shumë monedha?

Po. Çdo bilanc në një monedhë të vetme Fiat përfaqëson një produkt parash elektronike që plotëson përkufizimin përkatës.

Për qëllime raportimi sipas CRS, të gjitha Produktet e Përcaktuara të Parave Elektronike të mbajtura për një Mbajtës Llogarie konsiderohen si një Llogari Depozituese e vetme (notionale). Duhet të raportohet gjendja totale e llogarisë dhe interesi total i përfituar si një Llogari e vetme Depozituese. Zbatohen rregullat e përgjithshme të agregimit dhe konvertimit të monedhës sipas CRS, përfshirë për të përcaktuar nëse llogaria është Llogari e Përrjashtuar.

B. INSTITUCIONET FINANCIARE JO-RAPORTUESE

1. Statusi i një Banke Qendrore/ Organizate Ndërkombëtare/ Organi Qeveritar

A nuk konsiderohet kontradiktore nëse një Bankë Qendrore, Organizatë Ndërkombëtare apo Organ Qeveritar mund të përmbushë kushtet për t'u klasifikuar si Institucion Financiar Joraportues dhe si NFE Aktive?

Mënyra se si aplikohet Standardi ndaj një banke Qendrore, organizate Ndërkombëtare, ose organi Qeveritar është në varësi të fakteve. Përkufizimi i NFE përjashton shprehimisht Institucionet Financiare (Seksioni VIII, D(7)). Rrjedhimisht, testi I parë do të jetë nëse banka Qendrore, Organizata Ndërkombëtare ose Organi Qeveritar klasifikohet si Institucion Financiar. Ky është një test funksional dhe varet nga faktet. Nëse Banka Qendrore, Organizata Ndërkombëtare ose Organi Qeveritar përcaktohet se është një Institucion financiar, atëherë mund të klasifikohet si një Institucion financiar Joraportues, me kusht që të përmbushë kërkesat për të qenë i tillë, tek standardi (nënparagrafët (1), (2), (3) dhe (4) të Seksionit VIII, B dhe komentit shoqerues).

Nëse Banka Qendrore, Organizata Ndërkombëtare ose Organi Qeveritar nuk plotëson kërkesat për t'u klasifikuar si Institucion Financiar atëherë do të jetë një NFE dhe do të klasifikohet si një NFE Aktive (Seksioni VIII, D, (9) dhe komentit shoqerues).

2. Institucionet Financiare Jo-Raportuese me rrezik të ulët

Cila është marrëdhënia ndërmjet juridiksioneve specifike të kategorive të Institucioneve financiare Jo-raportuese me rrezik të ulët dhe përmbajtjes së Aneksit 2 të FACTA IGA-ve që janë duke u përfunduar në SHBA?

Në kategoritë e Institucioneve Financiare Jo-raportuese në Standard (Seksioni VIII, B dhe komenti përkatës) përfshijnë disa lloje institucionesh të parashikuar në Aneksin 2 të Modelit FATCA IGA. Gjatë procesit të hartimit të Standardit, u vendis që disa nga kategoritë e Aneksit 2 të Modelit FACTA IGA ishin ose të papërshtatshme, ose jo të dëshirueshme në kuptim të Standardit e për rrjedhojë, ato nuk u përfshinë. Këto përbënin kategori si Fonde të Daljes në Pension të kualifikuara sipas Traktatit, institucione Financiare me një Bazë Lokale Klientësh, Bankat Lokale, Institucionet Financiare vetëm me Llogari në Vlera të Vogla, Njësi të Sponsorizuara Investimesh dhe korporata të Huaja të Kontrolluara, Instrumente investimi të sponsorizuara ose të mbajtura ngushtë.

Gjithsesi, u vlerësua se mund të jenë disa Institucione Financiare specifike për juridiksionin, që në mënyrë të ngjashme paraqesin rrezik të ulët ndaj kategorive të përfshira në Standard, por, megjithatë, nuk mund të mos mbulohen nga kategoritë e parashikuara në Standard. Kështu, u parashikua një kategori e mbetur, për të lejuar Juridiksionet Pjesëmarrëse të identifikojnë në mënyrë specifike këto Institucione Financiare me rrezik të ulët, specifike për juridiksionin, si Institucione Financiare Joraportuese, me kusht që të plotësojnë kërkesat e parashikuara në Standard (Seksioni VIII, B, (1), c dhe Komenti shoqërues).

3. Llogaritë e Depozitave të mbajtura nga një bankë Qendrore

Një Bankë Qendrore është një institucion Financiar Joraportues, përvec sa i përket një pagese që rrjedh nga një detyrim në lidhje me një aktivitet financiar tregtar të llojit të ndërmarë nga një kompani e specifikuar e sigurimeve, institucioni i Kujdestarisë ose Institucioni Depozitues. Shih Seksionin VIII, nënparagrafin B (1) (a).

A duhet një Llogari e Depozitës mbajtur nga një Bankë Qendrore për punonjës in vet, të konsiderohet si detyrim i mbajtur në lidhje me një aktivitet financiar, që do të sjellë për Bankën Qendrore kryerjen e detyrimeve të duhura dhe raportimit, në lidhje me këtë llogari si Institucion Financiar Raportues?

Jo. Llogaria e Depozitave e mbajtur nga Banka Qendrore për punonjës aktualë ose të mëparshëm (dhe bashkëshorti dhe femijët e këtyre punonjësve) nuk do të konsiderohen të lidhur me një aktivitet financiar tregtar e për rrjedhojë, Banka Qendrore do të jetë një Institucion Financiar Joraportues në lidhje me Llogari Financiare të tilla.

4. Ndarja e Fondeve të Pensionit me Pjesëmarrje të Gjerë

Sipas Seksionit VIII (B)(5)(a) të CRS, kërkohet që në mënyrë që një Institucion Financiar të mund të kualifikohet si një Institucion Financiar Joraportues, sipas kategorisë së Fondeve të Pensionit me Pjesëmarrje të Gjerë, Institucioni Financiar duhet, ndër të tjera, të sigurojë se nuk ka asnjë përfitues të vetëm me të drejtën për më shumë se pesë përqind të asetëve të fondit. Në rast se fondi është ndare në nën-fonde, të cilët në praktikë veprojnë si produkte pensioni të ndara, duke përfshirë vecmin e asetëve, risqeve dhe të ardhurave të atribura ndaj këtyre nën-fondeve, testi i pesë përqindëshit zbatohet në nivel fondi, apo në nivel të cdo nën-fondi?

Në raste të tilla, testi nëse përfituesi i vetëm ka të drejtë në më shumë se pesë përqind të asetëve të fondit, do të zbatohet në nivel të secilit nën-fond.

5. Emetues i Kualifikuar i Kartës së Kreditit

“Emetues i Kualifikuar i Kartës së Kreditit” përkufizohet në Seksionin VIII(B)(8) si një Institucion Financiar që konsiderohet i tillë vetëm për shkak se është emetues i kartave të kreditit, i cili pranon depozita vetëm kur një klient kryen një pagesë që tejkalon balancën e detyrueshme të kartës dhe kjo pagesë e tepërt nuk i kthehet menjëherë klientit, si dhe që zbaton politika dhe procedura të caktuara brenda afatit të aplikueshëm për termin “Llogari e Re” në juridiksionin ku ky Institucion Financiar është subjekt i detyrimeve sipas CRS.

A mundet një juridiksion të përfshijë një Institucion Financiar në përkufizimin e “Emetuesit të Kualifikuar të Kartës së Kreditit” nëse ai i plotëson kërkesat e përcaktuara në Seksionin VIII(B)(8) dhe zbaton politikat dhe procedurat e kërkuara në një datë më të vonshme, por përpara fillimit të një periudhe të mëpasshme raportimi?

Po, me kusht që të gjitha politikat dhe procedurat e kërkuara të jenë në fuqi në fillim dhe gjatë gjithë periudhës së mëpasshme raportuese.

C. LLOGARIA FINANCIARE

1. Interesi i borxhit

Standardi parashikon se Llogaritë Financiare të një Njësië Investimesh janë interesat e tij në borxh dhe capital (Seksioni VIII, C, (1), a) dhe komentit shoqërues). Cili është përkufizimi i interesit në borxh?

Nuk ka një përkufizim të interesit në borxh të parashikuar në Standard.
Standardi parashikon se nëse një koncept nuk është përkufizuar, do të ketë një kuptim në përputhje me ligjin vendas të juridiksionit të zbatueshëm (Paragrafi 2 i Seksionit 1 i Marrëveshjes së Modelit të Autoritetit Kompetent). Rrjedhimisht, përkufizimi i interesit në borxh do të përcaktohet sipas ligjit të brendshëm të juridiksionit zbatues.

2. Llogaria e Përrjashtuar

Standardi parashikon se një kontratë për sigurimin e jetës me një periudhë mbulimi që do të përfundojë para se individi të arrijë moshën 90 vjecare, përbën një Llogari të Përrjashtuar, me kusht që të plotësojë kërkesat e listuara në Seksionin VIII, nënparagrafi C(17)(c). A mbulon ky përrjashtim edhe kontratat e sigurimit të jetës me afat?

Po. Standardi përfshin në Llogaritë e Përrjashtuara, kontrata të caktuara të sigurimit të jetës me afat, që përmbushin kushtet e specifikuara në Seksionin VIII, nënparagrafi C(17)(c). Shih Komentin e Seksionit VIII, paragrafët 86 dhe 91, në të cilët përdoret formulimi “kontrata të sigurimit të jetës me afat”.

3. Llogaria e Përrjashtuar – Llogaritë e fjetura

Standardi parashikon si një shembull të Llogarisë së Përrjashtur me Risk të Ulët, një llogari të fjetur me balancë vjetore që nuk kalon 1000 USD. Shih Komentin mbi Seksionin VIII, paragrafi 103, Shembulli 6.

Në kuptim të faktit se pragu prej 1000 USD është paraqitur si shembull, deri në çfarë mase mundën juridiksionet që zgjedhin të përfshijnë llogaritë e fjetura si Llogari të Përrjashtura me Risk të Ulët, të rregullojnë një prag më të lartë?

Edhe pse shuma prej 1000 USD është vetëm treguese, pritët që juridiksionet që zgjedhin të të përfshijnë llogaritë e fjetura si Llogari të Përrjashtura me Risk të Ulët, mos të rregullojnë një prag që kalon këtë shumë në mënyrë të konsiderueshme.

4. Derivatet OTC

Një Aset Financiar përkufizohet në CRS se përfshin “një letër me vlerë (për shembull, një përqindje aksionesh në një korporatë; partneritet ose interes përfitimi nga pronësia në një trust ose shoqëri tregtare me shumë aksionerë ose të kuotuar në bursë; dëftesë, bono, instrumente borxhi, ose evidenca të tjera borxhi), interesin e partnerit në partneritet, mallra, marrëveshje shkëmbimi (sëap) (për shembull, normë interesi swap, swap në valutë, swap bazë, kufijtë maksimalë të normës së interesit, kufijtë minimalë të normës së interesit,

swaps-et e mallrave, swaps-et e kapitalit, swaps-et e indeksit të kapitalit dhe marrëveshje të ngjashme), Kontratat e Sigurimeve ose Kontratat e Pensionit Vjetor, ose çdo interes (duke përfshirë kontratat future ose forward ose opsionet) në letra me vlerë, interes partneriteti, mallra, swap, Kontratë Sigurimesh ose Kontratë Pensioni Vjetor”. Shih seksionin VIII, paragrafi (A)(7).

A përfshin përkufizimi i Asetit Financiar, derivativat mbi-banak?

Po, përkufizimi i Asetit Financiar nuk bën dallim ndërmjet derivative të listuara në bursë ose derivative të tjera mbi-banak.

5. Llogaritë e Përrjashtuara – kushtet zëvendësuese – regjimi i gjobave

Në përputhje me nënparagrafin C(17)(g) të Seksionit VIII, një llogari mund të përfshihet në listën specifike të juridiksionit të Llogarive të Përrjashtuara, vetëm kur (i) llogaria paraqet rrezik të ulët për t’u përdorur për evazion tatimor, (ii) llogaria ka në mënyrë të konsiderueshme, karakteristika të ngjashme me ndonjë kategori të Llogarive të Përrjashtuara, të parashikuara në Standard, (iii) llogaria përkufizohet si Llogari e Përrjashtuar nga legjislacioni vendas dhe (iv) statusi i llogarisë si një Llogari e Përrjashtuar nuk pengon qëllimet e Standardit.

Në këtë kuptim, paragrafi 103 i Komentit të Seksionit VIII përmban një shembull në lidhje me kushtin (ii), duke u shprehur se një regjim sanksionesh (si taksa e e sheshtë e lartë) në tërheqjet e hershme nga një kontratë Pensioni Vjetor, trajtuar si një Llogari e Përrjashtuar sipas nënparagrafit C(17)(a), mund të përbëjë një kusht zëvendësues për të mos kufizuar kontributet e një Kontrate Pensioni Vjetor të tillë.

Si mund të interpretohet ky shembull, në vecanti në lidhje me faktin se Mbajtësi I Llogarisë I një Kontrate të Pensionit vjetor, mund të mos jetë resident për qëllime tatimore në juridiksionin e Institucionit Financiar që lëshon Kontratën e pensionit vjetor?

Regjimi i gjobave për tërheqjet e hershme të juridiksionit të Institucionit Financiar që ka lëshuar Kontratën e Pensionit Vjetor, një jo-rezidenti, duhet të sigurojë se sanksione të tilla duhet të mbledhen në mënyrë efektive nga juridiksioni i Institucionit Financiar. Në vecanti, juridiksioni i Institucionit Financiar duhet të sigurojë që ligji tatimor ndërkombëtar I zbatueshëm, duke përfshirë Konventat e taksimit të Dyfishtë, mos të pengojë mbledhjen efektive të këtyre gjobave.

6. Llogaritë e Përjashtuara – kushtet zëvendësuese – raportimi tek autoritetet tatimore

Në kuptim të Llogarive të Përjashtuara, fakti se informacioni në lidhje me një llogari, kërkohet të raportohet tek autoritetet tatimore, përbën një indikator për rrezik të ulët në kontekstin e përgatitjes së listave specifike për juridiksionin të Llogarive të Përjashtuara me rrezik të ulët, sipas nënparagrafit C(17)(g) të Seksionit VIII dhe një karakteristikë për klasifikimin e llogarisë së daljes në pension ose pensionit, si një Llogari e Përjashtuar sipas nënparagrafit C(17)(a) të Seksionit VIII.

A përbën fakti që informacioni në lidhje me një llogari kërkohet të raportohet tek autoritetet rregullatore dhe/ose të sigurimeve shoqërore të juridiksionit të Institucionit Financiar raportues, përfaqëson në mënyrë të konsiderueshme karakteristika të ngjashme për qëllime të klasifikimit të llogarive si Llogari të Përjashtuara?

Fakti që informacioni në lidhje me një llogari kërkohet të raportohet tek autoritetet rregullatore dhe/ose të sigurimeve shoqërore të juridiksionit të Institucionit Financiar raportues, përfaqëson vetëm në mënyrë të konsiderueshme karakteristika të ngjashme në masën që është siguruar me ligjin përkatës të brendshëm që informacioni i tillë të vihet në dispozicion të autoriteteve tatimore të juridiksionit të Institucionit Financiar Raportues.

7. Llogaritë e Përjashtuara – llogari të parave elektronike me vlerë të ulët

Sipas cilave kushte llogaritë e parave elektronike me vlerë të ulët që janë Llogari Depozite, mund të jenë Llogari të Përjashtuara sipas Seksionit VIII (C)(17)(g)?

Fakti që një Llogari Financiare është llogari e parave elektronike nuk do të thotë që Llogaria Financiare do të specifikohet nga një juridiksion në ligjin vendas si Llogari e Përjashtuar me rrezik të ulët. Në mënyrë që Llogari të tilla Financiare të specifikohen si Llogari të Përjashtuara sipas ligjit të brendshëm të një juridiksioni zbatues, në pajtim me Seksionin VIII (C) (17) (g), juridiksioni duhet të sigurojë që llogaritë paraqesin një rrezik të ulët për t'u përdorur për evazion fiskal, kanë karakteristika thelbësore të ngjashme me një kategori tjetër të Llogarive të Përjashtuara dhe që statusi i tyre si një Llogari e Përjashtuar nuk është në kundërshtim me qëllimet e CRS. Komenti i Seksionit VIII (C) (17) (g) jep shembuj të llogarive të tilla të përjashtuara specifike të juridiksionit me rrezik të ulët.

Si shembull i një llogarie të përjashtuar me rrezik të ulët në kontekstin e përfshirjes financiare, Shembulli 5 thekson që një Llogari e Depozitave, subjekt i rregullimit financiar (i) që ofron shërbime të përcaktuara dhe të kufizuara, në mënyrë që të rrisë përfshirjen financiare, (ii) mbi të cilën depozitat mujore nuk mund të kalojnë 1 250 USD dhe (iii) për të cilat Institucionet Financiare janë lejuar të zbatojnë procedurat e thjeshtuara të AML /

KYC në përputhje me Rekomandimet e FATF, mund të jenë një Llogari e Përrjashtuar nga rreziku i ulët.

Me kusht që llogaritë e parave elektronike të jenë të rregulluara dhe të plotësojnë kërkesat e Seksionit VIII (C) (17) (g), ato mund të përcaktohen si një Llogari e Përrjashtuar, nga juridiksioni zbatues. Shembulli i mësipërm mund të sigurojë udhëzime të mëtejshme se kur kërkesat e Seksionit VIII (C) (17) (g) do të përmbusheshin në kontekstin e përfshirjes financiare.

8. Përcaktimi i interesave në kapital, në rastin e CIV të mbajtura gjerësisht, që është një Institucion Financiar Raportues

Disa CIV që janë Institucione financiare Raportuese dhe që janë të organizuara në formën e një trusti, kanë karakteristikat e CIV-ve të ofruara publikisht: administrator I besuar dhe përfituesit janë palë jo të lidhura; interesat në CIV njësohen; CIV është e detyruar të mbajë një regjistër të azhurnuar të mbajtësve të njësive të regjistruara; mbajtës të caktuar të njësive të regjistruara janë Institucionet e Kujdestarisë që mbajnë njësitë në CIV, në emër të investitorëve në një Llogari të Kujdestarisë; dhe njësitë janë instrumente financiare të transferueshme lirshëm. A mund t'i trajtojë një CIV e tillë mbajtësit e njësive të regjistruara, si Mbajtës të llogarive të tyre për qëllime të CRS?

Po, në këtë rast këta mbajtës të njësive të regjistruara do të jenë Mbajtës të Llogarive të interesave në kapital në CIV (përveç nëse janë persona të ndryshëm nga një Institucion Financiar, që mbajnë interesin e kapitalit për përfitimin ose për llogarinë e një personi tjetër, siç përshkruhet në Seksionin VIII (E) (1)).

Institucionet e Kujdestarisë që janë mbajtës të njësive të regjistruara do të jenë përgjegjës për raportimin e interesave në kapital në CIV, të cilat i mbajnë për mbajtësit e llogarive të raportueshme në një Llogari të Kujdestarisë (shiko paragrafin 71 të komentit të Seksionit VIII).

9. Njësitë e Investimit – përkufizimi i Llogarisë Financiare

Sipas Seksionit VIII (C) (1) (b), një kapital ose interes në borxh në një institucion financiar të ndryshëm nga ato të përshkruar në Seksionin VIII (C) (1) (a), konsiderohet një llogari financiare vetëm nëse klasa e interesave u krijua me qëllim të shmangies së raportimit në bazë të CRS. Si zbatohet kjo rregull për interesat në kapital ose në borxh të mbajtura në një njësi që është njësi investimesh, vetëm sepse është një këshilltar investimesh ose një menaxher investimesh?

Seksioni VIII (C) (1) (b) zbatohet për interesat në borxh ose kapital, të mbajtura në një njësi që është Njësi Investimesh, vetëm sepse (i) jep këshilla për investime dhe vepron në emër të, ose (ii) menaxhon portofolet për , dhe vepron në emër të një klienti me qëllim investimin, menaxhimin ose administrimin e Aseteve Financiare të depozituara në emër të klientit me një Institucion Financiar, të ndryshëm nga një Njësi e tillë Investimi, nëse klasa e interesave të tilla është vendosur me qëllim shmangien e raportimit sipas CRS.

10. Llogaritë e Përrjashtuara – llogari të mbajtura për qëllim të godinës ose kooperativës së strehimit

Në kontekstin e Llogarive të Përrjashtuara, si duhet të klasifikohen llogaritë e mbajtura nga një grup pronarësh, me qëllim pagimin e shpenzimeve të vazhdueshme të një godine apo kooperative strehimi?

Në përputhje me Seksionin VIII (C) (17) (g) të CRS, juridiksionet mund të krijojnë një listë specifike të brendshme të Llogarive të Përrjashtuara, me kusht që Llogaritë e tilla Financiare të paraqesin një rrezik të ulët për t'u përdorur për shmangien e taksave, të kenë karakteristika thelbësisht të ngjashme me një prej kategorive të Llogarive të Përrjashtuara të parashikuara nga CRS në Seksionin VIII (C) (17) (a) përmes (f) dhe nuk janë në kundërshtim me qëllimet e CRS.

Në bazë të Seksionit VIII (C) (17) (b), një Llogari Financiare për qëllime të kursimit jo të daljes në pension, është një Llogari e Përrjashtuar kur (i) i nënshtrohet rregullimit si një instrument kursimi jo i daljes në pension, (ii) është favorizues ndaj tatimit, (iii) tërheqjet kushtëzohen nga plotësimi i kriterëve specifike dhe (iv) kontributet vjetore janë të kufizuara në 50,000 USD ose më pak.

Në këtë këndvështrim, një Llogari Financiare e mbajtur nga ose në emër të një grupi pronarësh, ose nga kompania e kondominiumit, me qëllim pagimin e shpenzimeve të godinës ose kooperativës së strehimit mund të përfshihet në juridiksionin specifik të listës së rreziqeve të ulëta të Llogarive të përrjashtuara, me kusht që: (i) të rregullohen në ligjin e brendshëm si llogari specifike për mbulimin e kostove të një godine apo kooperative strehimi, (ii) llogaria ose shumat e kontribuara dhe / ose të mbajtura në llogari janë të favorizuara nga taksat, (iii) shumat në llogari mund të përdoren vetëm për të paguar shpenzimet e godinës ose të kooperativës së strehimit dhe (iv) asnjë pronar i vetëm nuk mund të kontribuojë çdo vit një shumë që tejkalon 50,000 USD.

Kur disa nga kërkesat e mësipërme (siç është llogaria financiare që favorizohet nga taksat ose kufizimi i kontributeve në 50,000 USD) nuk përmbushen, karakteristika zëvendësuese ose kufizime që sigurojnë një nivel ekuivalent të rrezikut të ulët mund të merren në konsideratë, duke marrë parasysh specifikat e brendshme. Kjo mund të përfshijë karakteristika të tilla si: (i) jo më shumë se 20% e kontributeve vjetore dhe totale në vit, të

atribueshme ndaj një personi të vetëm, (ii) llogaria që drejtohet nga një profesionist i pavarur, (iii) shumat e kontributet dhe përdorimi i parave që vendosen me marrëveshje të pronarëve në përputhje me dokumentet përbërëse godinës ose kooperativës së strehimit, ose (iv) mos lejimi I tërheqjeve nga llogaria për qëllime të tjera nga shpenzimet e godinës ose kooperativës së strehimit.

11. Shpërndarjet indirekte nga trusti

Si trajtohen sipas CRS, shpërndarjet indirekte nga trusti?

Në bazë të Seksionit VIII (C) (4), një person i raportueshëm do të trajtohet si përfitues i një trusti, “nëse një person i tillë i raportueshëm mund të marrë, direkt ose indirekt, një shpërndarje diskrecionale nga trusti”.

Shpërndarjet indirekte nga një trust mund të lindin kur trusti kryen pagesa ndaj një pale të tretë, për përfitimin e një personi tjetër. Për shembull, rastet kur një trust paguan tarifatat e shkollimit ose ripaguan një kredi të marrë nga një person tjetër, duhet të konsiderohen shpërndarje indirekte nga trusti. Shpërndarjet indirekte përfshijnë gjithashtu raste kur trusti jep një kredi pa interes ose me një normë interesi më të ulët se norma e interesit të tregut ose në kushte të tjera jo të gjatësisë të krahut. Për më tepër, shlyerja e një kredie të dhënë nga një trust për përfituesit e saj përbën një shpërndarje indirekte në vitin kur kredia është shlyer.

Në të gjitha rastet e mësipërme personi i raportueshëm do të jetë personi që është përfitues i trustit, që merr shpërndarjen indirekte (d.m.th. në shembujt e mësipërm, debitori i tarifave të shkollimit ose marrësi i kushteve të favorshme të kredisë).

12. Mbajtësit e llogarisë në lidhje me kontratat e sigurimit të vlerës së parasë

Në lidhje me një kontratë të sigurimit të vlerës së parasë, a do të trajtohen personat që kanë të drejtën e aksesit në Vlerën e Parasë dhe të drejtën e ndryshimit të përfituesve të kontratës, si Mbajtës të llogarive për qëllime të CRS, nëse ata kanë hequr dorë nga të drejta të tilla?

Persona të tillë do të konsiderohen Mbajtës të Llogarive, në lidhje me Kontratën e Sigurimit të Vlerës së Parasë në të gjitha rastet, përveç nëse ata kanë hequr dorë në mënyrë përfundimtare, të plotë dhe të përvokueshme, nga e drejta e aksesit në Vlerën e Parsë dhe nga e drejta për ndryshimin e përfituesve të kontratës së sigurimit të vlerës së parasë.

Në rastet kur, duke marrë parasysh paragrafin e mësipërm, asnjë person nuk mund të hyjë në Vlerën e Parasë ose të ndryshojë përfituesit, Mbajtës i Llogarisë është çdo person i

emëruar si pronar i kontratës dhe çdo person që ka të drejtë të kryejë pagesa, sipas kushteve në kontratë.

Pavarësisht nga sa më sipër, me maturimin e një Kontrate të Sigurimit të Vlerës së Parasë (d.m.th. kur detyrimi për të paguar një shumë sipas kontratës bëhet fiks), çdo person që ka të drejtë të marrë një pagesë sipas kontratës, duhet të trajtohet si një Mbajtës i Llogarisë.

13. Llogaritë Financiare në kontekstin e aktivitetit të tregtimit me CFD

A mban një Institucion Financiar një Llogari Financiare sipas Seksionit VIII(C)(1) të CRS për shkak se mban fonde të klientëve në kuadër të aktivitetit të tij të tregtimit me CFD me këta klientë?

Meqenëse një Llogari Kujdestarie është një llogari që mban një ose më shumë Aktiva Financiare për përfitimin e një personi tjetër, dhe termi Aktiva Financiare nuk përfshin paranë (cash), llogaritë në të cilat Institucioni Financiar mban fondet e klientëve nuk përbëjnë Llogari Kujdestarie.

Megjithatë, këto llogari mund të përbëjnë Llogari Depozituese në masën që Institucioni Financiar i mban ato në rrjedhën e zakonshme të një aktiviteti bankar ose aktiviteti të ngjashëm.

D.LLOGARIA E RAPORTUESHME

1. Raportimi i Personave Kontrollues të caktuar

A duhet Personi/personat Kontrollues të Njësisë, resident në të njëjtin juridiksion me Institucionin Financiar Raportues, të raportohet?

Standardi kërkon vetëm raportimin e Personave të Raportueshëm të Juridiksionit. Personat e Raportueshëm të Juridiksionit janë persona rezidentë në një grup të caktuar juridiksionesh, siç përcaktohet në legjislacionin zbatues vendas të Juridiksionit Pjesëmarrës, ku ndodhet Institucioni Financiar (Seksioni VIII, D, (3)). Si minimum, kjo listë duhet të përfshijë juridiksione me të cilat Juridiksioni Pjesëmarrës ka një marrëveshje për shkëmbimin automatik të informacionit sipas Standardit.

Sidoqoftë, ekziston një qasje e diskutuar në Standard e cila do të lejonte një juridiksion pjesëmarrës të zgjerojë raportimin për të mbuluar rezidentët e vet që janë persona kontrollues, megjithëse kjo nuk është një kërkesë e Standardit (Paragrafi 5 i Shtojcës 5 të Standardit).

2. Njësitë Jo-financiare pasive

Një njësi është një Njësi Jo-financiare aktive nëse më pak se 50% e të ardhurave të tij janë të ardhura pasive dhe më pak se 50% e aseteve të tij prodhojnë ose mbahen për prodhimin e të ardhurave pasive. Po sikur asetet të krijonin të ardhura pasive, por në të vërtetë nuk prodhojnë të ardhura në periudhën në fjalë?

Testi nëse një aset mbahet për prodhimin e të ardhurave pasive (Seksioni VIII, D, (9), a) dhe Komenti i shoqëruar) nuk kërkon që të ardhurat pasive të prodhohen në të vërtetë në periudhën në fjalë. Përkundrazi, asetit duhet të jetë i llojit që prodhon ose mund të prodhojë të ardhura pasive. Për shembull, paratë duhet të shihen si prodhuese ose të mbajtura për prodhimin e të ardhurave pasive (interesit) edhe nëse në të vërtetë nuk prodhojnë të ardhura të tilla.

3. Të ardhurat pasive

CRS nuk përkufizon të ardhurat pasive, sidoqoftë, Komenti siguron një listë të artikujve që përgjithësisht duhet të konsiderohen si të ardhura pasive. Më tej, komenti parashikon që përcaktimi i të ardhurave pasive mund të bëhet duke iu referuar "rregullave të veçanta të çdo juridiksioni". Shihni Komentin në Seksionin VIII, paragrafi 126. Në përcaktimin e të ardhurave pasive, çfarë nënkuptohet me referencë për rregullat e veçanta të secilit juridiksion?

Për lehtësimin e zbatimit efektiv të Standardit, përkufizimi i juridiksionit për të ardhurat pasive duhet të jetë në thelb, në përputhje me listën e parashikuar nga Komenti. Secili Juridiksion mund të përkufizojë në rregullat e tij të veçanta, artikujt që gjenden në listën e të ardhurave pasive (si përsëmbull, të ardhurat ekuivalente me interesin), në përputhje me rregullat e brendshme.

4. Personi i raportueshëm – përkufizimi i tregtisë së rregullt

Seksioni VIII (D) (2) (a) parashikon që "një korporatë, aksionet e së cilës tregtohen rregullisht në një ose më shumë tregje të letrave me vlerë " nuk është një person i raportueshëm.

Në këtë drejtim, paragrafi 112 i komentit të Seksionit VIII parashikon që aksionet "tregtohen rregullisht" nëse ka një vëllim të konsiderueshëm tregtie në lidhje me aksionet mbi baza të vazhdueshme.

Paragrafi 113 i komentit jep udhëzime të mëtejshme në lidhje me kuptimin e "vëllimit të konsiderueshëm të tregtisë në lidhje me aksionet në vazhdim" në lidhje me secilën kategori aksionesh të aksioneve të korporatës.

Si interpretohet termi "secila klasë aksionesh e aksioneve të korporatës"?

Për qëllimet e Standardit, "secila klasë aksionesh e aksioneve të korporatës" nënkupton një ose më shumë kategori të aksioneve të korporatës që (i) ishin regjistruar në një ose më shumë tregje të letrave me vlerë gjatë vitit pararendës kalendarik dhe (ii), në total, përfaqësojnë më shumë se 50% të (a) fuqisë totale të kombinuar të votimit të të gjitha klasave të aksioneve të një korporate të tillë që kanë të drejtë të votojnë dhe (b) vlerën totale të stokut të një korporate të tillë.

5. Përkufizimi i NFE Aktive – aksione të tregtuara rregullisht në një treg të letrave me vlerë

Termi NFE aktive përfshin një NFE, aksionet e së cilës tregtohen rregullisht në një treg të themeluar të letrave me vlerë ose një NFE që është një njësi e lidhur e një njësie, stoku i të cilës tregtohet rregullisht në një treg të themeluar të letrave me vlerë. A mundet një njësi tjetër përveç një korporate të ketë "aksione që tregtohen rregullisht në një treg të themeluar të letrave me vlerë"?

Jo. Termi "aksion" është i kufizuar në aksione në një korporatë. Prandaj, vetëm një korporatë mund të kualifikohet si një NFE aktive në bazë të faktit që aksionet e saj tregtohen rregullisht në një treg të themeluar të letrave me vlerë.

6. Mbrojtësit e trustit që është Institucion Financiar Raportues

A konsiderohen mbrojtësit e trustit, që është Institucion Financiar Raportues, si Mbajtës Llogarie të trustit në të gjitha rastet, apo vetëm në rrethana ku pushteti i tyre është i tillë që mund të konsiderohet si ushtrim i kontrollit mbi trustin?

Mbrojtësi duhet të trajtohet si një Mbajtës Llogarie pavarësisht nëse ka kontroll efektiv mbi trustin.

7. Lloji i kodit të pagesës në lidhje me kontratën e Sigurimit të Vlerës së Parasë, Kontratën e Pensionit Vjetor, Interesin në kapital dhe interesin në borxh

A mund të përdoret kodi CRS504 për identifikimin e të gjithë llojeve të pagesave që raportohen në lidhje me një kontratë Sigurimi të Vlerës së Parasë, Kontratë Pensioni Vjetor, Interes në kapital dhe interes në borxh?

Po, kodi CRS504 mund të përdoret për identifikimin e të gjitha llojeve të pagesave që raportohen në lidhje me kontratën e Sigurimit të Vlerës së Parasë, Kontratën e Pensionit

Vjetor, Interesin në kapital dhe interesin në borxh, përfshirë këtu kur pagesa të tilla janë dividendë, kamatë, të ardhura bruto ose pagesa të shlyerjes. Standardi nuk kërkon përdorimin e ndonjë kodi specifik (d.m.th. CRS501, CRS502 or CRS503) për identifikimin e cdo lloj pagese që raportohet në lidhje me kontratën e Sigurimit të Vlerës së Parasë, Kontratën e Pensionit Vjetor, Interesin në kapital ose interesin në borxh.

8. Të ardhurat nga investimet e kapitalit të kompanive të sigurimit

A mundet që të ardhurat e mbledhura nga asetet për investimin e kapitalit të një biznesi sigurimesh, të trajtohen si të ardhura aktive?

Po. Në përcaktimin nëse të ardhurat janë pasive, është e rëndësishme të merret në konsideratë natyra e të ardhurave që merr biznesi i sigurimiti. Sic sygjeron edhe koncepti, të ardhurat pasive derivohen më tepër nga investimi në asete, sesa nga aktivitetet e kryera në rrjedhën normale të tregtisë apo biznesit. Për shkak të natyrës së të ardhurave të marra nga asetet e mbajtura si rezerva të biznesit ose rregullatore, të biznesit të sigurimeve, të ardhurat nga ky rast specifik mund të trajtohen më tepër si aktive, sesa pasive.

9. Juridiksionet e Raportueshme për Llogaritë e Njësive Paraekzistuese

Në kuptim të Llogarive të njësive Paraekzistuese, nga Institucionet Financiare kërkohet, bazuar në Seksionin V(D), përcaktimi nëse mbajtësi i Llogarisë së Njësive Paraekzistuese është resident në një ose më shumë Juridiksione të Raportueshme.

Në përputhje me paragrafin 10 të Komentit mbi Seksionin V, një Mbajtës I Llogarisë së Njësive paraekzistuese do të konsiderohet resident I një Juridiksioni të Raportueshëm nëse bazuar në informacionin e disponueshëm për Institucionin Financiar ka, ndër të tjera: Një vend të inkorporimit ose organizimit në një Juridiksion të Raportueshëm;

Një adresë në një Juridiksion të Raportueshëm (për shembull ë...] adresën e regjistruar, zyrën kryesore ose vendin e menaxhimit efektiv); ose

Një adresë të një ose më shumë administratorëve të besuar të trustit, në një Juridiksion të Raportueshëm.

Për qëllime të përmbushjes së detyrimeve të duhura, në lidhje me Mbajtësit e Llogarive të Njësive Paraekzistuese, a duhet të merren në konsideratë të gjitha indikacionet e mësipërme apo konsiderata të tjera, për të përcaktuar Juridiksionin e Raportueshëm të një Mbajtësi të vecantë të Llogarisë Paraekzistuese?

Po. Të gjitha indikacionet e sipërpërmendura dhe konsiderata të tjera duhet të mbahen parasysh për përcaktimin e Juridiksionit të Raportueshëm në lidhje me Mbajtësin e Llogarisë së Njësive Paraekzistuese dhe Institucionet Financiare duhet të vazhdojnë të

rishikojnë të gjithë informacionin e disponueshëm edhe pasi të gjendet ndonjë tregues I rezidencës. Mbajtësi i Llogarisë së Njesisë Paraekzistuese do të konsiderohet rezident i një Juridiksioni të Raportueshëm në cdo juridiksion për të cilin është gjetur një tregues, përveç nëse procedurat shëruese të parashikuara në Seksionin V(D)(1)(b) mund të zbatohen.

E. TË NDRYSHME

1. Përkufizimi i Njesisë së Lidhur në rastet e pronësisë indirekte

Në mënyrë që të përcaktohet nëse një Njësi është e lidhur me një Njësi tjetër, kërkohet që, në përputhje me nënparagrafin E(4) të Seksionit VIII të Standardit, të verifikohet nëse Njësia kontrollon Njësinë tjetër ose nëse dy njësitë janë nën kontroll të përbashkët. E njëjta dispozitë shprehet se kontrolli përfshin pronësinë direkte ose indirekte të më shumë se 50% të votës dhe vlerës në një Njësi.

Në rastin e pronësisë indirekte të votës dhe vlerës së një Njësie në një Njësi tjetër, a duhet të matet pronësia në mënyrë proporcionale?

Shembull:

Njësia A zotëron 51% të totalit të votave dhe 51% të vlerës totale të aksioneve të Njesisë B. Njësia B, nga ana tjetër, zotëron 51% të totalit të votave dhe 51% të vlerës totale të aksioneve të Njesisë C. A janë Njësia A dhe Njësia C, njësi të lidhura? Sipas rregullit proporcional, Njësitë nuk do jenë të lidhura pasi rregulli do të kërkonte që përqindjet e votave dhe vlerës të shumëzohen, ndërkohë që në realitet, Njësia A kontrollon efektivisht Njësinë C.

Njësitë konsiderohen si Njësi të Lidhura, nëse këto Njësi janë të lidhura ndërmjet një ose me shumë zinxhirësh pronësie, nga një Njësi mëmë e përbashkët dhe nëse Njësia mëmë e përbashkët zotëron më shumë se 50% të aksioneve ose interesave të tjerë në kapital, të paktën në njërin nga Njësitë e tjera. Një zinxhir i pronësisë do të kuptohet si pronësia nga një ose më shumë Njësi, të 50% të pushtetit total të votimit të aksioneve të një Njësie dhe më shumë se 50% të vlerës totale të aksioneve të një Njësie.

Shembull:

Njësitë A dhe C konsiderohen si Njësi të Lidhura, sipas nënparagrafit E(4) të Seksionit VIII, pasi Njësia A zotëron në mënyrë direkte më shumë se 50% të totalit të votave të aksioneve dhe më shumë se 50% të vlerës totale të aksioneve të Njesisë B dhe sepse Njësia B zotëron në mënyrë direkte më shumë se 50% të totalit të votave të aksioneve dhe më shumë se 50% të totalit të vlerës së aksioneve të Njesisë C. Njësitë A dhe C janë, për rrjedhojë, të lidhura nëpërmjet zinxhirëve të pronësisë. Pavarësisht faktit që Njësia A

proporcionalisht zotëron vetëm 26% të vlerës totale të aksioneve dhe të drejtës së votës së Njesisë C, Njësia A dhe Njësia C janë Njësi të lidhura.

2. Të ardhurat nga investimet e kapitalit të kompanive të sigurimit

A mund të trajtohen të ardhurat e marra nga asetet për investimin e kapitalit në një biznes sigurimi, sit ë ardhura aktive?

Po. Në përcaktimin nëse të ardhurat janë pasive, është e nevojshme të merret në konsideratë natyra e të ardhurave që merr biznesi i sigurimit. Sic sygjeron edhe koncepti, të ardhurat pasive derivohen më tepër nga investimi në asete, sesa nga aktivitetet e kryera në rrjedhën normale të tregtisë apo biznesit. Për shkak të natyrës së të ardhurave të marra nga asetet e mbajtura si rezerva të biznesit ose rregullatore, të bizneist të sigurimeve, të ardhurat nga ky rast specifik mund të trajtohen më tepër si aktive, sesa pasive, përveç nëse rezerva të tilla are inflated në mënyrë abuzive.

ÇËSHTJE TË TJERA

1. Mbrojtja e të dhënave - ISO-27000

Standardi i referohet serisë ISO-27000 në lidhje me ruajtjen e të dhënave. A është një kërkesë e Standardit që seria të aplikohet dhe nëse po, kërkohet një certifikim?

Më shumë se përshkruese, seria ISO-27000 siguron një qasje në menaxhimin e rrezikut përmes rekomandimeve të praktikës më të mirë për menaxhimin e sigurisë së informacionit, rrezikut dhe kontrollit. Qasja e saktë e ndërmarrë do të formohet nga konteksti i sistemit të përgjithshëm të administrimit të sigurisë së informacionit që ka administrata tatimore. Për më tepër, ka qasje të tjera që mund të shihen mbrojtje ekuivalente. Prandaj ekziston një pritje që juridiksionet ose të zbatojnë seritë ISO 27000, një standard ekuivalent ose të kenë një justifikim të arsyeshëm se përse është e arsyeshme të largohen prej tij në kontekstin e një administrate të veçantë tatimore. (Referencat për serinë ISO-270000 mund të gjenden në paragrafin 13 tek Komenti i Seksionit 3 dhe paragrafi 12 tek Komenti i Seksionit 5 të Marrëveshjes Model të Autoritetit Kompetent).

2. Si veprohet me llogaritë paraekzistuese individuale ku mungon TIN?

Sipas kërkesave të përgjithshme të raportimit në lidhje me secilën Llogari të Raportueshme që është një Llogari Para-ekzistuese ose në lidhje me secilën Llogari Financiare që është hapur para se të bëhet një Llogari e Raportueshme, TIN-i ose data e lindjes nuk kërkohet të raportohet nëse ky TIN ose data e lindjes nuk është në regjistrat e Institucionit Financiar

Raportues dhe nuk kërkohet të mblidhet nga ky Institucion Financiar Raportues sipas legjislacionit të brendshëm. Pavarësisht këtij parashikimi, një Institucion Financiar Raportues duhet të bëjë përpjekje nga ana e tij për të marrë TIN-in dhe datën e lindjes në lidhje me Llogaritë Para-ekzistuese deri në fund të vitit të dytë kalendarik pas vitit në të cilin Llogaritë Para-ekzistuese janë identifikuar si Llogari të Raportueshme.

3. Ku gjendet komentari i Standartit të Raportimit të Përbashkët (CRS)?

Në portalin e OECD-së për shkëmbimin automatik të informacionit mund të gjendet edhe Komentari i Standartit të Raportimit të Përbashkët:

<https://www.oecd.org/tax/automatic-exchange/common-reporting-standard/common-reporting-standard-and-related-commentaries/>

4. Çfarë përmbajtje duhet të kenë formularët e vetëdeklarimit?

OECD ka publikuar në faqen e saj disa lloje formularësh vetëdeklarimi që shërbejnë për të ilustruar informacionin e mbajtësit të llogarisë që duhet mbledhur nga institucionet financiare, në kuadër të implementimit të Standartit të Raportimit të Përbashkët. Formularët e vetëdeklarimit të sugjeruar nga OECD janë të veçantë: Për personat kontrollues, entitetet dhe individët dhe shembuj të tyre mund të gjenden në portalin e OECD: <https://www.oecd.org/tax/automatic-exchange/crs-implementation-and-assistance/>. Lidhur me implementimin dhe asistencën për zbatimin e CRS dhe mbledhjen e vetëdeklarimeve, OECD ka theksuar se institucionet financiare duhet të këshillohen me konsulentët e tyre për t'u siguruar se veprimet lidhur me zbatimin e CRS dhe formularët e vetëdeklarimit të mbledhur nga llogarimbajtësit të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Si raportohet informacioni nga institucionet financiare raportuese tek Autoriteti Kompetent?

Formati i miratuar për komunikimin e të dhënave të raportimit financiar është formati XML i CRS-së. Institucionet financiare nëpërmjet webservice-ve të cilat do të ekspozohen në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit do të transmetojnë të dhënat e përcaktuara sipas standartit.